



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji UBT” të datës 09.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për ndërtimin Memoriali Përkujtimor Adem Jashari - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-11469-4-1-3, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji UBT” të datës 09.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për ndërtimin Memoriali Përkujtimor Adem Jashari - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-11469-4-1-3.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji UBT” (tutje “parashtruesi”) me datë 09.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për ndërtimin Memoriali Përkujtimor Adem Jashari - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-11469-4-1-3.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

*“Në lidhje me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për ndërtimin e Memorialit Përkujtimor Adem Jashari – RITENDER”, nr. i prokurimit 616-25-11469-4-1-3, kërkojmë sqarim zyrtar lidhur me mënyrën e vlerësimit të ofertës së dorëzuar nga Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji – UBT dhe Alfa-Product SH.P.K. Sipas Fletës së të Dhënave të Tenderit, oferta është dashur të dorëzohet në dy folderë/skedarë të mbyllur me fjalëkalim, përkatësisht “Projekti Ideor” dhe “Dokumentacioni i Kandidatit”. Po ashtu, në FDT është përcaktuar se Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga operatori ekonomik ndarjen e kredencialeve për projektin ideor pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave, ndërsa kredencialet për dokumentacionin e kandidatit në ditën e hapjes së ofertave financiare.*

*Duke qenë se UBT & Alfa-Product nuk janë kontaktuar dhe nuk u janë kërkuar fjalëkalimet/kredencialet për hapjen e folderëve, kërkojmë të sqarohet se: mbi cilën bazë është hapur dhe vlerësuar “Projekti Ideor” i UBT & Alfa-Product; kur, nga kush dhe në çfarë mënyre janë pranuar kredencialet/fjalëkalimet; cili është procesverbali i hapjes së folderit “Projekti Ideor”; cili është procesverbali i dorëzimit të projektit ideor te juria; cilat janë fletët individuale të vlerësimit të secilit anëtar të jurisë; si është arritur pikëzimi prej 65.64 pikësh teknike; a është hapur apo jo “Dokumentacioni i Kandidatit” dhe në cilën datë/orë”.*

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

Nuk i keni përmbushur kërkesat e FDT-së

#### ARSYETIM

**Tenderi juaj është diskualifikuar për këto arsye:**

- Nuk keni arritur që të tejkaloni pragan minimal prej 70 pikëve teknike siç ka qene e parapare në DT dhe në Njoftimin për kontrate pika 23.1 vlerësimi i koncept projekteve ku parashihet se:**  
**Piket totale për kritere 100, ndërsa pragu minimal 70 pikë për tu vlerësuar me një rën nga të tre çmimet.**  
**Proporcioni ndërmjet pikëve teknike dhe çmimit duhet të jetë 70 pikë – pjesa teknike, 30 pike çmimi me i lirë.**

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për

eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 12.06.2026**



**Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës**

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.